



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

RELACION

Data

Nr. Prot

PROJEKTVENDIM
PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", Z. ERIN PJETER GJONI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 15551 Prot., datë 06.10.2023, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Adelina Pashko Toma, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, për këshillin e bashkisë Lezhë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 15, z. Erin Pjeter Gjoni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit Partia Socialdemokrate, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër LE-PSD-4943_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Erin Pjeter Gjoni, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë

- nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”,
1. Gjykata Shkodër me vendimin nr. 74, datë 01.03.2010 e ka dënuar me 2 (dy) vite shërbim prove për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
 2. Alba, Itali me vendimin nr. 345/11, datë 27.09.2011, ka vendosur pezullim burgimi për veprën penale të parashikuar në nenin 163 SS CP,
 3. në Malin e Zi është dënua me gjobë 300(treqind) euro në Dhjetor 2017, pa përcaktuar veprën penale;
- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”,
 1. Prokuroria Alba Itali, në shtator 2011, dënua me pezullim burgimi,
 2. Prokuroria Mal i Zi, në dhjetor 2017, dënua me gjobë 300(treqind) euro;
 - Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”
 1. Prokuroria Shkodër në vitin 2011, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
 2. Prokuroria Alba, në Bra Itali në korrik 2011, i dyshuar për ngatërrësë,
 3. Policia kufitare Malin e Zi për në Dhjetor 2017, i dyshuar për vulë fallco;
 - Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Subjekti vetëdeklarues ka qenë emigrant në Cuneo, Itali në vitin 2011.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4998 Prot., datë 11.05.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 170 prot., datë 19.01.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 168 Prot., datë 19.01.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Erin Pjeter Gjoni.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 170/1 Prot., datë 29.01.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për

anëtar z. Erin Pjeter Gjoni, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjëndjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 168/1 Prot., datë 25.01.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për z. Erin Pjeter Gjoni, ku konstatohet se kandidati rezulton të jetë i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Erin Pjeter Gjoni, në Këshillin e Bashkisë Lezhë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Jona JOSIFI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALDEMOKRATE", Z. ERIN PJETER GJONI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 15551 Prot., datë 06.10.2023, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Adelina Pashko Toma, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, për Këshillin e Bashkisë Lezhë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 15, z. Erin Pjeter Gjoni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456
Ora: hh:mm



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, z. Erin Pjeter Gjoni"

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore të subjektit Partia Socialdemokrate, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër LE-PSD-4943_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Erin Pjeter Gjoni, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”,
 1. Gjykata Shkodër me vendimin nr. 74, datë 01.03.2010 e ka dënuar me 2 (dy) vite shërbim prove për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
 2. Alba, Itali me vendimin nr. 345/11, datë 27.09.2011, ka vendosur pezullim burgimi për veprën penale të parashikuar në nenin 163 SS CP,
 3. në Malin e Zi është dënuar me gjobë 300(treqind) euro në Dhjetor 2017, pa përcaktuar veprën penale;
- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”,
 1. Prokuroria Alba Itali, në shtator 2011, dënuar me pezullim burgimi,
 2. Prokuroria Mal i Zi, në dhjetor 2017, dënuar me gjobë 300(treqind) euro;
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”
 1. Prokuroria Shkodër në vitin 2011, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
 2. Prokuroria Alba, në Bra Itali në korrik 2011, i dyshuar për ngatërresë,
 3. Policia kufitare Malin e Zi për në Dhjetor 2017, i dyshuar për vulë fallco;
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Subjekti vetëdeklarues ka qenë emigrant në Cuneo, Itali në vitin 2011.

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4998 prot., datë 11.05.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 170 Prot.,

datë 19.01.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 168 Prot., datë 19.01.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Erin Pjeter Gjoni.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 170/1 Prot., datë 29.01.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Erin Pjeter Gjoni, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 168/1 Prot., datë 25.01.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti) për z. Erin Pjeter Gjoni, ku konstatohet se kandidati rezulton të jetë i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Erin Pjeter Gjoni, në Këshillin e Bashkisë Lezhë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialdemokrate, z. Erin Pjeter Gjoni.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI